



## SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparografi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparografi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparografi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "KOSPROD" Sh.P.K. të datës 13.09.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "168 Pajisje IT - Tabela Digitale" me nr. të prokurimit 616-25-6962-1-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHEȚ** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "KOSPROD" Sh.P.K. të datës 13.09.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "168 Pajisje IT - Tabela Digitale" me nr. të prokurimit 616-25-6962-1-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "KOSPROD" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 13.09.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "168 Pajisje IT - Tabela Digitale" me nr. të prokurimit 616-25-6962-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistonjë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Faqe 1 nga 6

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: “”.

## Pretendimi nr. 1:

### Pretendimi 1: ( Plani Shtrirjes se rrjetave MS VISO )

Në FDT me konkretisht 9.1 & 9.2, pika 9 kerkesa si:

9. OE duhet që para Ofertimit tē përgatitë një planë mostër (shembull), të instalimt tē rrjetave në MS Visio dhe të sjell në zyretn e prokurimit. 9. Plani i shtrirjës së rrjetave (Pasive, Aktive) duhet tē përgatitët në MS Visio (Mostër pér një shkollë me 10 njësi mësimore) – duke duhet tē përfshihen të gjitha komponentet e cekuar ne Aneksin 1. Që tē prezantojtë në mënyrë vizuale përgatitjen profesionalë pér implementimin tē projektit. Planit – Mostër duhet tē silljet fizikisht në USB apo CD, ditën e hapjes deri ora 12:00.

Neni 1 / LPP Nr.04/L-042 (Qellimi) – Kërkesa tejkalon qëllimin e procedurës së prokurimit. Planit i shtrirjes së rrjetave është përgjegjësi e Autoritetit dhe nuk mund t'u ngarkohet operatorëve.

Neni 7 (Barazia në trajtim / jo-diskriminimi) – Kërkesa krijon hapësirë pér vlerësim subjektiv dhe selektiv, duke cenuar konkurrencën e lire dhe tē drejtë.

Neni 28 (Specifikimet teknike) – Nuk është përcaktuar qartë mënyra e vlerësimit tē planit mostër, duke bërë kriterin jo-transparent.

Neni 52 (Njoftimi i kriterieve për dhënien e kontratës) – Kriteri i dorëzimit të planit nuk është njoftuar paraprakisht dhe nuk është i qartë pér tē gjithë operatorët.

Cdo ekspert teknik apo shqyrtues do te miratonte nje kerkese te tillë, sepse Autoritetet duhet te kenë kërkesat e sakta dhe nuk duhet te shkelin ligjin si ne kete rast:

Lidhur me kërkesën e Autoritetit Kontraktues e Tenderit, sipas së cilës Operatorët Ekonomikë duhet tē dorëzojnë një plan mostër tē instalimit tē rrjetave në MS Visio para ofertimit, shprehim kundërshtimin tonë, pasi një kërkësë e tillë është e pabazuar dhe e paligjshme. Planifikimi i shtrirjes së rrjetave është përgjegjësi ekskluzive e Autoritetit Kontraktues si përfitues i shërbimit dhe nuk mund t'u ngarkohet operatorëve ekonomikë që marrin pjesë në tender, pasi kjo krijon hapësirë pér vlerësim subjektiv, në kundërshtim me parimin e transparencës dhe barazisë së trajtimit. Për më tepër, kjo praktikë vendos pengesa të panevojshme pér operatorët ekonomikë dhe kufizon konkurrencën e lire dhe tē ndershme, duke rrezikuar tërë ligjshmërinë e procedurës së prokurimit. Nëse AK ka nevojë pér planifikimin tē detaujar tē rrjetit, kjo duhet tē bëhet nga vetë AK dhe tē përfshihet si pjesë e dokumentacionit teknik, në mënyrë që operatorët tē kenë vetëm detyrimin pëtë që zbatuar saktësisht. Për këto arsy, kërkjmë që kjo kërkësë tē hiqet menjëherë nga Dokumentet e Tenderit, pasi vetëm kështu mund tē garantohet një proces i drejtë, objektiv dhe i ligjshëm.

### Përgjigje nga AK:

- AK vlerëson se përpilimi i një plani MOSTER, është i domosdoshëm, pér tē vlerësuar kapacitetet Teknike – Profesionale tē OE.
- AK vlerëson se një kompani e TI duhet tē ketë kapacitetet minimale pér dizajnimin dhe planifikimin e një rrjeti tē brendshëm ne Objekte Shkollore.
- Qëllimi i kërkësës është Identifikimi I kapaciteteve Teknike /Profesionale tē OE.

Pretendimi ankimore është I pabazuar. Kërkesa pér plan MOSTER – në MS VISION qëndron.

## Pretendimi nr. 2:

### Pretendimi 2: ( Ndarje ne Lote )

Në dosjen e tenderit është vërejtur se një numër i madh artikujsh nga fusha tē ndryshme janë përfshirë në një kontratë tē vetme, pa asnjë ndarje sipas kategorive tē tyre.

Sipas kërkësave ne DT dhe Neneve shohim se kemi te bejme me ndeshje te kërkësave me LPP-ne:

Neni 6 (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti) – Bashkim i pajisjeve tē ndryshme nuk sjell përfitim ekonomik dhe kufizon tregun.

Neni 7 (Barazia në trajtim / jo-diskriminimi) – Operatorët me ekspertizë tē veçantë nuk mund tē konkurrinë në mënyrë tē barabartë.

Neni 27/A (Ndarja e kontratave në Lote) – Ligji lejon ndarje në lote pér tē mundësuar plesëmarrje tē gjerë dhe konkurrencë më tē madhe.

Ky bashkim i pajisjeve tē ndryshme në një lot tē vetëm bie ne ndesh me parimet e konkurrencës së ndershme dhe trajtimit tē barabartë tē operatorëve ekonomikë, tē garantuara me Ligjin pëtë Prokurimin Publik. Praktika e tillë kufizon pjesëmarrjen e shumë operatorëve që kanë ekspertizë vetëm në segmente tē caktuara, duke ua pamundësuar atyre konkurrimin e drejtë. Në këtë aktivitet përvëq tabelave digitale, tē cilat janë qëllimi kryesor i projektit, janë përfshirë edhe produkte tē rrjetit, elemente elektrike dhe materiale montimi industrial, tē cilat nuk kanë asgjë tē përbashkët me vetë funksionalitetin e tabelave. Këto janë kategori krejtësisht tē ndryshme mallrash dhe nuk është e arsyeshme që tē trajtohen si një paketë e vetme. Një qasje e tillë shkon kundër parimit tē ekonomicitetit dhe efikasitetit, pasi nuk i jep asnjë përfitim autoritetit kontraktues, përkundrazi e ngushton tregun dhe zgjelon konkurrencën.

Si operator ekonomik, ne jemi tē specializuar ne furnizimin e instalimin e tabelave digitale dhe kemi kapacitetin profesional pér ta realizuar këtë pjesë tē projektit me cilësi dhe efikasitet. Por kërkësat pér furnizime tjera tē papërpunshme me këtë kategori na vendosin në pozitë tē pabarabartë, duke mos reflektuar realisht aftësitët dhe ekspertizën tonë.

Për këtë arsy, kërkjmë që pajisjet e përfshira në këtë tender tē ndahen në lote tē veganta, sipas ngjashmërisë së tyre, në mënyrë që secili operator ekonomik tē ketë mundësinë tē ofrojë në fushën ku ka përgatitje dhe eksperiencë profesionale. Kjo do tē garantonte një proces më transparent, më konkurruës dhe plotësisht tē përpunshëm me ligjin. Pas rishikimit dhe ndarjes në lote, është e domosdoshme që tē shthyhet edhe afati i dorëzimit tē

3/3

ofertave, meqë ndryshimet në dosjen e tenderit kërkijnë kohë shtesë pér përgatitjen e dokumentacionit.

## Faqe 2 nga 6

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks.gov.net

## Përgjigja nga AK:

- AK konsideron se Implementimi në plotni i projketit është qëllimi kryesor sipas kërkesave të AK. Gjithashtu procedurat e prokurimit lejojnë Konserciumet apo bashkimin e 2 apo më shumë OE për të arritur qëllimin e projektit.

## Pretendimi ankimore është i pabazuar.

### Pretendimi nr. 3:

#### Pretendimi 3: ( Peshimi i çmimeve )

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit, kemi vërejtur se metodologja e përcaktuar për vendosjen dhe vlerësimin e çmimeve është e pasaktë dhe në kundërshtim me parimet e prokurimit publik.

Neni 6 (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti) – Pesa jo proporcionale nuk garanton zgjedhjen e ofertës më të favorshme.

Neni 7 (Barazia në trajtim / jo-diskriminimi) – Operatorët penalizohen në mënyrë jo të drejtë për produkte me rëndësi të ndryshme.

Neni 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) – Vlerësimi nuk është transparent dhe nuk siguron barazi.

Neni 60 (Kriteret për dhënien e kontratës) – Kriteret e çmimit janë të qarta dhe nuk mundësojnë vlerësimin të drejtë.

Kërkjmë përcaktimin e sasisë reale për çdo artikull dhe rishikimin e metodologjisë së vlerësimit në mënyrë proporcionale me rëndësinë e secilës kategori. Në rast mungese korrigimi, procedura duhet të anulohet dhe të rihapet me kritere të qarta, transparente dhe jo-diskriminuese.

Autoriteti ka kërkuar që për secilin artikull të jetë çmim për njësi (1 copë), ndërkohë që sasia reale që do të nevojitet nuk është e përcaktuar qartë. Kjo sasje e bën të pamundur kupumin e saktë të nevojave të Autoritetit Kontraktues, pasi nuk dihet se cilat produkte do të kërkohen realisht dhe në çfarë sasish do të porositen.

Në këtë formë, operatorët ekonomikë detyrohen të jenë përmes përcaktimit të çmimit për secilin pozicion pa e ditur nëse ato do të porositen ndonjëherë, ndërsa Autoriteti mbetet me një mekanizëm të paqartë që nuk siguron transparencë dhe barazi. Ekziston reziku që gjatë zbatimit të kontratës të kërkohet vetëm një artikull i caktuar, ndërsa pozicionet tjera të mbeten të papërdorura, çka sjell pabarazi dhe vendos operatorët në kushte të padrejta.

Për më tepër, metodologja e përcaktuar për vlerësimin e ofertave është e gabuar, pasi peshët janë shpërndarë në mënyrë jo proporcionale. Produktet dytësore me rëndësi të vogël janë vlerësuar me peshë më të lartë, ndërsa pajisjet kryesore me vlerë më të madhe financiare kanë marrë peshë më të ulët. Një shpërndarje e tillë krijon hapësirë për manipulim të çmimeve, çon në vlerësimin të padrejtë dhe nuk garanton zgjedhjen e ofertës më të favorshme për Autoritetin Kontraktues. Kjo bie ndesh me parimet e përcaktuara në Ligjin për Prokurim Publik, veçanërisht me nenin që kërkon vlerësim proporcional dhe të drejtë të ofertave.

Në këtë drejtim, kërkjmë nga Autoriteti Kontraktues:

Rishikimin dhe korrigimin e përskrimit të çmimeve, duke përcaktuar sasi reale dhe të qarta për çdo artikull;

Rishikimin e metodologjisë së vlerësimit, në mënyrë që përshtatet sasi reale;

Në rast se këto korrigjime nuk mund të bëhen brenda procedurës aktuale, kërkjmë anulimin e saj dhe rihapjen me kritere të qarta, transparente dhe jo-diskriminuese.

Shiqoni ju lutem se si eshte vepruar:

1.00	A - Gjithsej (1 - 61) : 50%
2.00	B - Gjithsejt (62 - 70) : 30%
3.00	C - Gjithsejt (71 - 96) : 20%

Pra per shtrirje te rrjetave kemi peshim 50%

Per pajisje si switch router kemi 30% dhe

Per Smartboard Tabela digjitale kemi 20%

Nese shiqohet ndarja ne përqindje këtu duket se kemi te bëjmë me projekt per kabllim dhe pajisje interneti pasi që këto 2 Tabela A dhe B marrin ne total

80% te peshës se projektit, derisa Komuna e Prishtines kërkon blerjen e tabelave gjithnjë ne baze te titullit te aktivitetit: 168 Paisje IT-Tabela Digitale Ne kërkjmë nga Autoriteti që te rishkoj kete projekt dhe te dalim me një vendim te kërkesës per rishqyrtim duke përmirësuar apo ndarë këto produkte dhe duke treguar saktësishë kërkesat dhe sasie e kërkua. Si përfundim ky projekt duket që nuk ka per qellim furnizimin me Tabela Digitale por me shtrirjen e rrjetave. Ky rishqyrtim është thelbësor për të siguruar një proces të drejtë, konkurrues dhe në përpunje me interesin publik, duke u mundësuar të gjithë operatorëve ekonomikë të konkurrojnë në kushte të barabarta dhe duke i dhënë Autoritetit ofertën më cilësore dhe më të favorshme financiarisht.

## Përgjigja nga AK:

- AK siguron të gjithë OE – se forma e vlerësimit është standard i njëjtë i vlerësimit për të gjithë OE dhe si e tillë është transparente dhe nuk përbën shkelje të vlerësimit Transparent.
- AK sqaron se renditja është bërë sipas prioriteteve të AK – dhe nuk ka të bëj me peshim jo-proporcional.
- AK sqaron se çmimi për njësi, është vendosur për shkak të natyrës së punës. Është pothuajse e pamundur me determine në fazën e ofertimit se sa metër Kabell UTP

## Faqe 3 nga 6

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: [visar.shehu@rks-gov.net](mailto:visar.shehu@rks-gov.net)

nevojiten për shtrirje të rrjetës, mundet me të nevojiten 100m, 1000m apo 10 000 m, varion nga forma e implementimit. Apo se sa WiFi duhet me u instaluar, pasi që në raste të caktuara kur trashësia e murit të një shkolle është më e madhe se ajo standard pengon shpërndarjen e rrjetës dhe rrjedhimisht paraqitet nevoja për WiFi shtesë. Prandaj kërkohen çmimet për njësi në mënyrë që edhe Faturimi kur të bëhet të bëhet sipas punëve që janë implementuar.

- Gjithsesi forma e vlerësimit të procedurës së tenderimit për të gjithë OE – është e njëjtë dhe si e tillë nuk përbën shkelje të transparencës apo diskreditime të OE dhe si e tillë forma aktuale qëndron.

## Pretendimi ankimore është i pabazuar.

### Pretendimi nr. 4:

#### Pretendimi 4: ( Produktet e rrjetit te mbyllura me autorizime )

Duke shgyrtuar specifikimin teknik të referuar në Aneksin 1 (përshtkrimi i çmimeve), vërejmë se për disa produkte të Tabelës B (Nr. 35, 37, 38, 39, 40 dhe 41) kërkohet autorizim nga prodhuesi ose distributori. Konkrektisht produktet numer:

35: Firewall Router  
37: WiFi 7 Access Point (AP)  
38: Switch 28-port L2+ PoE me 10G uplinks  
39: Switch 52-port L2+ PoE me 10G uplinks  
40: Router

41: Hardware Controller

Bazuar ne kërkesat specifike te modeleve dhe bashkimin e tyre me kriterin e Autorizimeve kemi te bëjmë me ndeshje te kërkesave me LPP-ne:

Neni 28 (Specifikimet teknike) – specifikimet e mbyllura kufizojnë konkurrencën.

Neni 7 (Barazia në trajtim / jo-diskriminimi) – operatorët e tjerë nuk mund të ofrojnë produktet e tyre.

Neni 52 (Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës) – kritaret për autorizim nuk janë qartë të komunikueshme.

Neni 69 (Aftësia teknike dhe/ose profesionale) – kufizimi pengon ofertues me aftësi të barabartë.

Vërejmë se këto produkte janë specifikuar me modele të caktuara dhe kërkohen autorizime që vetëm disa operatorë ekonomik mund t'i sigurojnë. Si pasojë, kjo e mbylli mundësinë për ofertim nga operatorët e tjerë ekonomik dhe kufizon konkurrencën në mënyrë të papërshtatshme, duke krijuar një situatë selektive që nuk është në përputhje me ligjin e prokurimit publik.

Sipas Ligjit për Prokurimin Publik, specifikimet teknike duhet të jenë transparente dhe të barabarta për të gjithë operatorët ekonomik, në mënyrë që mundësohet ofertim konkurrues dhe i lirë. Aktualisht, kërkesat për autorizim të prodhuesit/distributorit për produktet e sipërpermendura kanë krijuar barriera që pengojnë operatorët e tjerë të ofrojnë produktet e tyre.

Për këtë arsy, kërkojmë nga Autoriteti që:

Të rishagyrtojë dhe të heqë kërkesat për autorizim specifik për produktet e Tabelës B. Të sigurojë që specifikimet teknike të jenë të hapura dhe të mundësojnë ofertim nga të gjithë operatorët ekonomik, duke promovuar konkurrencë të drejtë.

Si mbështetje të kësaj ankesë, mund të ofrojmë modelet e saktë të produkteve dhe shembuj se si është e pamundur të merret autorizimi për këto produkte, duke demonstruar se specifikimet aktuale shërbejnë për të mbyllur procesin për ofertues të caktuar dhe jo për të gjithë, kjo mund te vertetohet edhe nga ekspertet me një shfletim të lehte me vone.

Duke marrë parasysh vlerën e lartë të projektit dhe situatën aktuale ekonomike, lehtësimi i kritereve do të mundësojë ofertim konkurrues dhe të barabartë, gjë që është parakusht për një proces transparent dhe ligor. Ju lutemi të reflektoni dhe të merrni vendim të drejtë për rishagyrtim të kësaj çështjeje.

**Pretendimi 4: Tabelat e Menqura te vequra si model, te peshuara pak dhe te mbyllura me autorizim )**

Duke shqyrtuar specifikimin teknik te projektit "Furnizim me Tabela Digitale", vërejmë se për Tabelën C (posicionet 71 – 96), e cila ka peshë 20% në vlerësimin total të ofertës, kërkohet specifikim i veçantë që dërgon direkt tek një prodhues.

Ne mund të ofrojmë produktin e kërkuar, por për shkak të kërkesës për autorizim nga prodhuesi, nuk mund të ofertojmë këtë produkt, pasi operatorët ekonomik nuk mund të sigurojnë autorizim përmes modeleve të caktuara. Kjo krijon një barrierë artificiale që kufizon konkurrencën dhe pengon ofertim të lirë.

Vërejmë gjithashtu se pesha e projektit është e shpërndarë si më poshtë:

A – Gjithsej (1–61): 50%

B – Gjithsej (62–70): 30%

C – Gjithsej (71–96 – Tabela Digitale): 20%

NO	Rikapitulimi
1.00	A - Gjithsej (1 - 61) : 50%
2.00	B - Gjithsej (62 - 70) : 30%
3.00	C - Gjithsej (71 - 96) : 20%

Pra ne kete rast kemi te bëjmë me kërkesa teknike dhe kërkesa kombinuese per Autorizim dhe gjithashtu mangësi sasie e ne kete rast shkelen nenet si :

Neni 28 (Specifikimet teknike) – specifikim i mbyllur për një model të vetëm.

Neni 7 (Barazia në trajtim / jo-diskriminimi) – kufizon ofertim të lirë.

Neni 65 (Provueshmëria e kandidatëve ose tenderues) – operatorët nuk mund të sigurojnë autorizim, duke shkelur mundësinë përmes ofertim të barabartë.

Kërkesa aktuale përmes Tabelat Digitale është problematike, sepse:

Operatorët ekonomik nuk mund të marrin autorizim direkt nga prodhuesi.

Përdorimi i distributorit nuk është zgjdhje reale, pasi prodhuesi nuk ka distributor të autorizuar në rajonin tonë.

Specifikimi teknik është i lidhur direkt me një model të vetëm duke penguar përdorimin e produkteve alternative që mund të përbushin të njëjtat kërkesa.

Për këto arsy, kërkojmë që Autoriteti të rishqyrtojë kriterin dhe:

Të heqë kërkesën përmes ofertim me garanci nga prodhuesi ose distributori, ose

Të rishkojë specifikimet teknike në mënyrë që të mundësohet ofertim nga produktet digitale të tjera që përbushin funksionalitetin e kërkuar. Ky veprim do të sigurojë konkurrencë të lirë, transparente dhe të barabartë përmes ofertim të operatorët ekonomik, duke respektuar ligjin përmes prokurimit publik dhe duke garantuar interesin e Komunës së Prishtinës. Nese nuk reflektohet ne largimin e autorizimeve apo lëshimin e specifikimeve per tabela digitale që mund te ofrohen nga te gjithë operatorët ne do te kërkojmë ndihme nga Ekspertet ku me rastin e ankesës do te prezantojmë saktësisht modelet e kërkura te cilat nuk plotësohet nga brendet e tjera.

### Përgjigja nga AK:

- AK vlerëson se përmes ofertave të gjitha produktet e specifikuara në paramasë ka më shumë se 2-3 brende që i plotësojnë specifika teknike të AK.
- AK sqaron se përpilimi i specifikave teknike është bërë duke u bazuar në praktikat më të mira vendore dhe ndërkombëtare, që garanton funksionalitet dhe siguri, dhe që përmes AK – është esenciale.
- AK vlerëson se Autorizimi nga Prodhesi është esencial – i domosdoshëm përmes ofertave të shmangur mundësitë e manipulimit nga OE – me branda të blear nga Tregu i ZI, potencialisht dhe jo me garancion Valid nga Prodhesi.
- AK: SMART BOARD të peshuar më pak, vlen sqarimi i njëjtë me pretendimin ankimore Nr.3.

### Pretendimi ankimore është i pabazuuar.

Sipas nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë përmes ofertave të projekteve, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe paralogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, paralogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese.

### Faqe 5 nga 6

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: [visar.shehu@rks-gov.net](mailto:visar.shehu@rks-gov.net)

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtuesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtuesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënët më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 16.09.2025

Visar SHEHU



#### Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Faqe 6 nga 6

---

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000  
Tel.: 038-200-40-111  
Email: [visar.shehu@rks-gov.net](mailto:visar.shehu@rks-gov.net)